

Kur duhet të bëni **Testin PCR** për COVID-19?

Testimi për COVID-19 gjendet gjerësisht në Masaçusets. Gjeni një qendër testimi pranë jush dhe vizitoni [About COVID-19 Testing](#) (rreth testimit të COVID-19) për të mësuar rreth llojeve të ndryshme të testeve të COVID-19, kur të testoheni dhe çfarë të bëni po të dilni pozitiv.

Kemi dy lloj testesh të COVID-19 që gjenden me lehtësi për të gjithë; testi antigen i shpejtë, të cilin mund ta bëni në shtëpi vetë, dhe testet PCR, që janë teste të bëra në klinikë, si në qendrat e testimit Commonwealth's Stop the Spread (të Komonuelthit Ndalni Përhapjen).

DPH këshillon se testet antigen të shpejta janë një alternativë e pranueshme për testin PCR në shumicën e situatave, përfshi skenarët e mëposhtëm:


- Për të dalë nga izolimi ose karantina, në përputhje me udhëzimin e DPH
- Për të bërë terapinë si me antitropa monoklonale ose ilaçe antivirale në se pacienti paraqet rrezikshmëri të lartë me pasoja të rënda

Testet antigen të shpejta COVID-19:

Testet antigen të shpejta (si kitet e testeve në shtëpi) mund të përdoren lehtësisht, dhe rezultatet i merrni brenda më pak se 15 minutave.

Ku të gjeni një:

- Pa recetë në farmacitë lokale, si në CVC ose Walgreens
- Në shitësit e tjerë me pakicë, si në Amazon ose Walmart
- Ato mund të shpërndahen edhe nëpërmjet punëdhënësve, programeve komunale, drejtorive shkollore dhe partnerëve të tjerë komunalë.
- Testet të porositura me postë nga qeveria federale:
 - Administrata e Bidenit i ka vënë në dispozicion falas testet e shpejta për COVID-19 në shtëpi për të gjithë banorët nëpërmjet një platforme të re porositëse në internet.
 - Çdo familje ka të drejtën për të marrë 4 kite testesh nëpërmjet këtij programi.
 - Këto teste antigen të shpejta në shtëpi und të porositen nga U.S. Post Office në [COVID Home Tests | USPS](#).



Mbulimi i sigurimit shëndetësor për testet antigen të shpejta

- Testet antigen të shpejta (në shtëpi) mbulohen tani nga sigurimi, siç kërkohet nga qeveria federale. Për më tepër informacion për mbulimin, ju lutemi vizitoni [How to get your At-Home Over-The-Counter COVID-19 Test for Free | CMS.gov](#).
- Kompanitë e sigurimeve shëndetësore do të mbulojnë 8 teste në shtëpi të marra pa recetë për individët e mbuluar në muaj. Anëtarët e MassHealth përfshihen në këtë.
- Banorët duhet të bisedojnë kompaninë e sigurimit për informacion se si i mbulon plani testet pa recetë dhe ku të blihen testet nëpërmjet farmacive të preferuara dhe shitësve me pakicë, meqenëse hollësitë mund të ndryshojnë. Banorët duhet të bisedojnë me kompaninë e sigurimit përpara se të blejnë testet në online si në Amazon, sepse mund të mos mbulohet kostoja e plotë.

Testet PCR gjenden në qindra qendra në të gjithë Komonuelthin, përfshi 40 qendra testimi të sponsorizuara nga shteti "Stop the Spread" (Ndalni Përhapjen) falas për banorët e Masaçusetsit. Për të gjetur listën e plotë të vendeve, vizitoni www.mass.gov/gettested